



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5258 prot.

Ballsh më, 02.11.2023

VENDIM

Nr. 48 Datë 30/10/2023

**PËR DHËNIEN E MENDIMIT NEGATIV PËR UNIFIKIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM DHE LARGIMIN
(KANALIZIME) TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e takasave vendore”, Udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB nr. 46, datë 30.08.2022 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizimeve” Marrëveshjes së Bashkëpunimit për transferim aktiviteti nr. 1361 Rep., Nr. 619 Kol date 07.10.2022 ndermjet Sh.a Ujesjetllës Kanalizime Mallakaster dhe Shoqerise Rajonale Ujesjetllës Kanalizime Fier, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak, VKB nr. 61 datë 24.11.2022 “Per Taksat dhe Tarifat Vendore per Vitin 2023”, shkresës me nr. 2209 Prot., datë 19.09.2023 “Kërkohet mendimi i Këshillit Bashkiak për unifikim të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 4442 Prot., datë 21.09.2023, relacionit shpjegues ekonomik që mbështet propozimin për ndryshim të tarifave të shërbimit UK për Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime sh. A. Fier,

VENDOSI

1. Dhënien e mendimit negativ për unifikimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura sipas vlerave bashkëlidhur shkresës me nr. 2209 Prot., datë 19.09.2023 të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a.
2. Ky vendim shoqërohet me shkresën me nr. 2209 Prot., datë 19.09.2023 “Kërkohet mendimi i Këshillit Bashkiak për unifikim të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 4442

Prot., datë 21.09.2023, relacionit shpjegues ekonomik që mbështet propozimin për ndryshim të tarifave të shërbimit UK për Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime sh. A. Fier.

3. Një kopje e këtij vendimit i përcillet Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.

KRYETAR

Nexhmi Sula

